



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO



MAMUŞA BELEDİYESİ – KOMUNA E MAMUSHËS

OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 626-23-5229-1-3-6/C139

KOMUNA E MAMUSHËS të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Operatori Ekonomik PROGLOBAL SH.P.K., 28 Nentori, nr. 129, me numër unik të biznesit: 811500794, selia në Prishtinë të cilin me autorizim e përfaqëson z. Ardian Vitija, në cilësinë e punëtorit të operatorit ekonomik (ne vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjeter, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizime si më poshtë:

**Titulli i kontratës: FURNIZIMI ME PAISJE PËR FIKJEN E ZJARRIT** me numër identifikues:

626-23-5229-1-3-6 dhe nr. të brendshëm 626-23-012-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë furnizimi me pajisje përfikjen e zjarrit nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

FURNIZIMI ME PAISJE PËR FIKJEN E ZJARRIT			
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia
1	<i>Furnizimi me Strajca-Pompa shpinore përfikjen e Zjarreve Fushore-Malore, Strajca të jetë prej materialit Cordure, rezervuari i brendshëm te jete minimumi 20 litra, Fiskaja jo koroduese me pompim të dyfishtë, distanca e vrushkullit të plotë minimumi 12 metra,, distanca e vrushkullit shpërndarës minimumi 8 metra, të ketë shiritin reflektose në shpinë, të ketë rripa përpjekim në belin e përdoruesit përbartjen sa më të lehtë, të ketë vend përvendosjen e veglave shtesë, të ketë të gjitha pjesë rezervë, zona e veprimit të jetë prej -10° C deri +75° C,</i>	Copë	6

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

<p><i>Furnizimi me pompa thithëse ujit, pompa të jetë me rrymë 220V dhe 8,2 A, fuqi minimale 1,1 kW e 1,5HP, pompa te jete me kapacitet rrjedhës minimum 550 L/Min , me shpejtësi rrrotullimit minimum 2850 RPM, diametri i daljes te jete Ø75, gjatësia maksimale e thithjes se ujit min. 8 m , gjatësia e largimit/sjelljes se ujit minimum 200 m</i></p>	<p>Copë</p>	<p>2</p>
---	-------------	----------

#### Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **Dhjetë (10)** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Vendi kryesor i dorëzimit dhe realizimit te projektit eshtë objekti i Zjarrfikësve në Komunën e Mamushës.**

2.3 Inkotermi<sup>2</sup> i zbatueshëm do të jetët : **DDP (detyrat e dërguara të paguara) Çmimi i ofertës përfshin të gjitha taksat, ngarkesat dhe obligimet e tjera të paguara.**

#### Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkuar vendi në fjalë.

#### Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **1,798.90 €; Njëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë Euro e nëntëdhjetë Eurocent.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronhet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>2</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare


## Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe<sup>3</sup> në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Furnizuesin.

Emri:	Gazmend Gashi	Emri:	Ardian Vitija
Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit	Pozita:	Punëtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	21.06.2023	Data:	21.06.2023
Vula:		Vula:	

## KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 626-23-5229-1-3-6/C139

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

<sup>3</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

1.8 “Çmimi i kontratës” do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përpunje me shresa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 “Shërbimet pas shitjes” do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin përvendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkesa e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkizati me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkësë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

## Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

#### **Neni 6 Ndihami lidhur me rregulloret vendore**

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënët mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuar ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendlodë që të marrë lejet e kërkuar apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

#### **Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit**

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontraten me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përmes fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

#### **Neni 8 Prejardhja**

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

#### **Neni 9 Siguria e ekzekutimit**

9.1 Furnizuesi do t'ë, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënës në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se përkohshme të pranimit.

#### **Neni 10 Sigurimi**

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

#### **Neni 11 Programi i realizimit**

11.1 Nëse kërcohët në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilit Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe

ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsyе autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe asfatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesi nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin te njofoj vendimin e tij te aprovimit i përmendur ne Nenin 11.2 brenda afateve te përmendura ne kontratë programi i tillë i realizimit duhet te konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Ne qoftë se nuk ka afat te caktuar, ato do te konsiderohet te aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim te ai.

11.5 Para pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të janë në detaje të tillë që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualet dhe vizatimet do të janë në gjuhën e kontratës dhe në forma dhe numrat të tillë të deklaruara në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të përkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tillë janë furnizuar Autoritetit Kontraktues

## Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësish përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

## Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

## Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrave

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njofimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë të drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mblidhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

## Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- Forca madhore;
- Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim përfshirë se mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta përfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

## Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në konratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë konratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë përfshirë kompensim; dhe
- të hyjë në një konratë me një palë të tretë përfshirë dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet përfshirë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

## Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar përfshirë dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjeter, nga përkëqësimi, humbja apo dëmtimi përfshirë sa t'i jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me konratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në konratë; ose
- b) është i nevojshëm përfshirë arsyet e kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm përfshirë shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm përfshirë siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjesë të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë përfshirë shtesa në çmimin e kontratës përvèç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit përfshirë pezulluar progresiv e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë përfshirë ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkositë me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është përfshirë shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njofuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë t'ë vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose t'ë ndërpresë konratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënes ose realizimi të kontratës bëhet e pavlefshme përfshirë shkak të gabimeve përbajtjesore, parregullsive ose mashtrimi, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrimi i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcione me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimi.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që t'i verifikohet nëse gabimet përbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në t'i vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përbajtjesore ose parregullsitë do t'i janë t'ë gjitha shkelje të kontratës ose dispozitatë rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkaktojnë humbje në buxhetin e

## Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jetep mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

## Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë përvonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektive të tilla, Furnizues do të:

- I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përvç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimini, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit te Autoriteti kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospjatimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrëthana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

## Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Furnizues sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

20.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjtë formular, që i bashkëngitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i jepin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

## Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të janë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjafueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperaturë ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rendë në të gjitha pikat gjatë transhit.

21.3 Paketimi, shënim i dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të janë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

## Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të janë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe që kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- që puna e bëre ose mallrat e dorëzuar apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhet ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

22.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojet ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

## Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të janë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuar, dhe të janë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm

atëherë kur furnizimet tē jenē tē gatshme pér pranim tē pérkohshém. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit tē furnizuesit do tē veprojë sipas njërsës nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit tē pérkohshém me një kopje pér Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në tē cilën sipas mendimit tē tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë tē gatshme pér pranim tē pérkohshém; ose
- tē refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin tē cilin, sipas mendimit tē tij e kërkon Furnizuesi pér ta lëshuar certifikatën.

23.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë tē pamundur që tē vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar pér pranim tē pérkohshém ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë pér ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do tē përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në tē cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuan. Furnizuesi nuk do tē nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave pér tē evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje tē përshtatshme pér pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose tē lëshojë certifikatën e pranimit tē pérkohshém ose tē refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do tē konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit tē asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit tē pérkohshém konsiderohet se përbën certifikatë tē pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahan me kontratë në pjesë, Furnizuesi do tē ketë tē drejtë tē bëjë kërkesë pér certifikatë tē veçantë pér secilën pjesë.

23.5 Në raste tē dorëzimit tē pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon tē drejtën pér tē dhënë pranim tē pjesshëm e tē pérkohshém.

23.6 Pas pranimit tē pérkohshém tē furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e pérkohshme dhe materialet që nuk kerkohen më pér përdorim përkizati me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do tē heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe tē bëjë ndonjë ndryshim tē gjendjes së vendit tē pranimit siç kerkohen në kontratë.

#### **Neni 24 Obligimet pér garanci**

24.1 Furnizuesi do tē garantojë që furnizimet tē jenë tē reja, tē papërdorura, tē modeleve tē fundit dhe tē përfshijë tē gjitha përmirësimet e kohëve tē fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kerkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do tē garantojë që asnjë nga furnizimet tē mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do tē mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

24.2 Furnizuesi do tē jetë përgjegjës pér mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë tē furnizimeve tē cilat mund tē paraqiten, apo tē ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe tē cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo tē mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi tē bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër tē tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime tē veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo tē mund tē praktikohet. Periudha e garancisë pér tē gjithë artikujt e ndërruar ose tē riparuar do tē fillojë përsëri nga data në tē cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do tē vazhdohet vetëm pér atë pjesë tē furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor tē paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund tē:

- a) tē korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose tē punësojë dikë tjetër pér ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në tē cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do tē zbritet nga paratë që duhet tē paguhen ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga tē dy;
- b) në rast se nuk ka sasi tē duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që tē merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) tē ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do tē parashihen në KVK dhe në specifikit teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do tē jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do tē fillojë në datën e pranimit tē pérkohshém.

#### **Neni 25 Shërbimet pas-shitjes**

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kerkohen në kontratë, do tē jepen në pajtim me tē dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do tē marrë përsipër tē realizojë ose tē organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe tē riparimit tē furnizimeve dhe tē sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund tē saktësojë që Furnizuesi tē sigurojë ndonjë ose tē gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë tē bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë tē cilat Autoriteti kontraktues mund tē vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës

- b) nē rast tē ndërprerjes sē prodhimit tē pjesëve rezervë, duhet tē lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues pér t'i mundësuar që tē blejë pjesët e kerkua dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kerkohen dhe kur kerkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

## Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit tē periudhës sē garancisë ose, nē rastet kur ka më tepér se një periudhë, pas skadimit tē periudhës sē fundit, dhe atëherë kur tē janë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë tē pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën nē tē cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe nē mënyrë tē tillë që autoriteti kontraktues tē jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do tē lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës sē garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kerkuar sipas Nenit 24 tē janë përfunduar nē mënyrë tē tillë që tē jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do tē konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa tē jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa tē konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do tē mbeten tē detyruar pér plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit tē certifikatës përfundimtare tē pranimit dhe tē cilat kanë mbetur tē parealizuara nē kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve tē tillë do tē përcaktohen duke iu referuar dispozitave tē kontratës.

## Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin tē shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do tē ketë tē drejtë pér këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

27.3 Përveç masave tē sipërpërmendura, mund tē jepen dëmshpërblime. Ato mund tē janë:

- a) dëme tē përgjithshme; ose
- b) dëme tē likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave tē parapara nē këtë nen do tē zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

## Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën nē ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi nē mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon nē përbushjen brenda një afati tē arsyeshëm tē paralajmërimit tē dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai tē evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim pér tē realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe tē cilat ndikojnë nē mënyrë serioze nē realizimin e duhur dhe me kohë tē punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent nē realizimin e urdhrave administrative tē dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë nē marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është nē ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë nē legislacionin apo nē rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar pér një shkelje që ka tē bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor pér sjellje tē rëndë tē keqe jo profesionale tē dëshmuar me çfarëdo mjeti tē cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* pér mashtrim, korruption, përfshirje nē ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare tē Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër tē prokurimit ose procedure tē dhënies së një granti tē finançuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze tē kontratës pér mosrealizim tē obligimeve tē veta kontraktuese;
- j) tē gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime nē personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen nē suplementin e kontratës;

- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershmë të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushojë së ekzistuar menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të janë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përbullur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjeluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të janë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërtet kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

## **Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit**

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

## **Neni 30 Forca madhore**

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhreve të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

**Neni 31****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shih të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 32****Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## **KUSHTET E VEÇANTA**

Numri i kontratës: **626-23-5229-1-3-6/C139**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i> Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dy palëve kontraktuese.
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	<b>Kushtet dhe detyrimet</b>
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikson do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	3.1	N/A
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	4.1	Përgjegjësia e kontraktuesit është në rast të shkaktimit të dëmeve në persona, staf apo objekte përreth. Operatori Ekonomik është përgjegjës për sigurimin e punëtoreve të tij dhe do ti bartë të gjitha pasojat në rast të ndonjë lëndimi gjatë ekzekutimit të furnizimeve, gjatë transportit dhe në objektet e pranimit.
Cilësia e furnizimeve	5.1	Furnizimet duhet të kenë cilësi të lartë dhe duhet ti përbahen me përpikëri specifikacionit teknik në dosje të tenderit. Operatori ekonomik duhet të jap një garacion të pajisjeve minimum 12 muaj nga data e pranimit teknik të pajisjeve nga komisioni për pranim teknik.
Inspektimi dhe testimi	6.1	Menaxheri i Projektit: Menaxheri i projektit do të caktohet me vendim të Kryetarit pas nënshkrimit të kontratës i cili do të bëjë menaxhimin e kontratës sipas vendimit të lartcekur.

Dorëzimi	7.1	Materialet duhet të dorëzohen nga Operatori Ekonomik tek autoriteti kontraktues brenda afatit prej Dhjetë (10) ditëve nga data e marrjes së porosisë nga personat përgjegjës.
Shërbimet pas shijes	8.1	Periudha për përmirësimin e defekteve është 5 ditë pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Menaxherit të kontratës në rast e konstatohet që materiali nuk i plotëson specifikat teknike.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	9.1	Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo te shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do ti sugjerojnë palës tjetër mbi variantin e zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshje.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	10.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike</b> në pajtim me legjislacionin në Kosovë.



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

**Përshkrimi i Çmimit**

**626-23-5229-1-3-6**

**626-23-012-1-3-6**

**Furnizim me pajisje per fikje te zjarrit**

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Shuma
1	<i>Furnizimi me Strajca-Pompa shpinore per fikjen e Zjarreve Fushore-Malore, Strajca të jetë prej materjalit Cordure, rezervuari i brendëshëm te jete minimumi 20 litra, Fiskaja jo koroduese me pompim të dyfishtë, distanca e vushkullit të plotë minimumi 12 metra,, distanca e vrushkullit shpërndarës minimumi 8 metra, të ketë shiritin reflektoese në shpinë, të ketë ripa për përthakim në belin e përdoruesit për bartjen sa më të lehtë, të ketë vendë përvendosjen e veglave shtesë, të ketë të gjitha pjesë rezerv, zona e veprimit të jetë prej -10 ° C deri +75° C,</i>	Copë	6.00	185.00	1,110.00
2	<i>Furnizimi me pompa thithëse ujit, pompa të jetë me rrymë 220V dhe 8,2 A, fuqi minimale 1,1 kW e 1,5HP, pompa te jete me kapacitet rrjedhes minimum 550 L/Min , me shpejtësi rrrotullimit minimum 2850 RPM, diametri i daljes te jete Ø75, gjatesia maksimale e thithjes se ujit min. 8 m , gjatesia e largimit/sjelles se ujit minimum 200 m</i>	Copë	2.00	344.45	688.90
<b>Totali i përgjithshëm duke i përfshirë të gjitha taksat dhe tatime e aplikuara</b>					<b>1,798.90</b>

**IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK**

Emri i OE:	<b>PROGLOBAL SHPK</b>
Adresa e plotë:	Dardani, 28 Nentori, Li-2, Lok. 3/1, Prishtine
I përfaqësuar nga:	
Mbiemri:	Latif Imeri
Pozita:	Drejtør
Nënshkrimi:	
Data:	31.05.2023
Vula:	



## Autorizim

Autorizohet **Ardian Vitija**, me numer personal **1234083453**, qe te nenshkruaj kontraten me Komunen e Mamushes per tenderin;

Tenderi: **FURNIZIMI ME PAISJE PËR FIKJEN E ZJARRIT**

Numri i prokurimit: **626-23-5229-1-3-6**

Data: 21.06.2023

Prishtinë

PROGLOBAL SHPK  
Latif Imeri, Drejtor



PROGLOBAL SH.P.K.  
+38344148645 | [info@proglobal-ks.com](mailto:info@proglobal-ks.com) |  
Address: 28 Nëntori LL-2 Lok. 3/1 Prishtinë 10000.  
Republic of Kosovo  
[www.proglobal-ks.com](http://www.proglobal-ks.com)